

PROCESVERBAL
nga seanca e 34-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 30.08.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë : /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Argjend Xhelili, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 34-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 11-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 20.08.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 33-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 20.08.2024.
3. Propozim – vendim për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-204, datë 24.07.2024 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Shërbim i telefonisë fikse.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Token.

6. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit - Dezinifikim dhe spërkatje, në ambientet e punës Pallati "Panko Brashnarov".
7. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 11-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 20.08.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 33-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 20.08.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Petrushevski në lidhje me Propozim - vendimin për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-204, datë 24.07.2024, për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, sugjeroi që shqyrtimi i propozimit të shtyhet për një orë, përkatësisht të bëhet pauzë deri në orën 15, dhe për arsyen tha se drejtori do të japë shpjegim.

Z. Trajçevski shpjegoi se për të marrë vendim Këshilli, për anulimin e Vendimit të miratuar më parë, është e nevojshme të plotësohen disa kushte nga ana e transmetuesit. Ai deklaroi se janë plotësuar kushtet formale për transaksionet financiare të transmetuesit, por ka pasur gabim teknik në dokumentacionin e dorëzuar për një të punësuar në televizion, për këtë që ditën e djeshme janë udhëzuar ta korrigjojnë. Dokumentet e korrigjuara origjinale transmetuesi i ka sjellë në arkivin e Agjencisë, para fillimit të seancës në orën 13:30. Për këtë arsye materialet për këtë pikë nuk janë dorëzuar sepse janë duke u kontrolluar nga sektori dhe do t'u dorëzohen anëtarëve të Këshillit që nga momenti kur do të kontrollohen, plotësohen dhe arkivohen dhe për këtë arsye është e nevojshme të bëhet pauzë.

Këshilli i Agjencisë nuk kishte kundërshtim që pika të shtyhet dhe të vazhdohet për shqyrtim në orën 15.00.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska sqaroi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Shërbim për telefoni fikse. Ajo shpjegoi se ky shërbim është i paraparë në Planin vjetor të Agjencisë për furnizim publik dhe mjetet janë të parashikuara me Planin Financiar të Agjencisë për këtë vit, por kontrata që do të rezultohet do të lidhet për tre vjet, në mënyrë që mjetet të planifikohen në përputhje me planet financiare për vitet e ardhshme. Sipas shumës së paraparë të mjeteve, furnizimi do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizim publik për këtë lloj procedure. Theksoi se të gjitha të dhënat e tjera gjenden në materialet pas pikës.

Z. Petrushevski tha se i ka shqyrtuar materialet dhe ka vërejtur se bëhet fjalë për mjete shumë të vogla, rreth 75 mijë denarë për tre vjet. Ky shërbim theksoi se përdoret gjithnjë e më pak, por për arsye teknike duhet të zbatohet. Ai deklaroi se do të japë mbështetje.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim i telefonisë fikse.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën shërbim i telefonisë fikse është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, pra do të sigurohen shtesë dhe në Planin Financiar për vitet 2025 dhe 2026.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Token. Ajo ka sqaruar se për fillimin dhe zbatimin e tij janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Është paraparë dhe në Planin vjetor për furnizim publik të Agjencisë dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për këtë vit. Sipas shumës së paraparë të mjeteve, furnizimi do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizim publik për këtë lloj procedure. Të gjitha të dhënat e tjera gjenden në materialet pas pikës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Token.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Token, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit - Dezinfikim dhe spërkatje, në objektet e punës të Pallatit "Panko Brashnarov". Ajo shpjegoi se për këtë furnizim nuk vlejnë dispozitat e Ligjit për furnizim publik sepse është furnizim nën kufijtë e vlerës së Ligjit për furnizim publik. Për të siguruar transparencë në disponimin e mjeteve, janë pranuar dy oferta, nga ku njëra prej të cilave është më e pranueshme ekonomikisht. Ajo deklaroi se në shumën e mjeteve do të marrë pjesë edhe Ministria e Sportit.

Z. Trajçev, lidhur me shpjegimin e udhëheqëses Mitrevska, tha se Këshilli i Agjencisë e miraton vetëm nevojën dhe mjetet financiare por nuk vendos se cila nga ofertat do të zgjidhet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për furnizim të shërbimit - Dezinfikim dhe spërkatje, në ambientet e punës Pallati "Panko Brashnarov", me vlerë nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligji për furnizim publik.

Për shërbimin e lartpërmendur fondet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Për realizimin e shërbimit - Dezinfikim dhe spërkatjen e të gjithë objektit të Pallatit "Panko Brashnarov" do të kryhet ndarja e mjeteve financiare të nevojshme në raport të duhur,

përkatësisht: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale 69,33% dhe Ministria e Sportit 30,67 %, pas pëlqimit të dorëzuar nga ana e tyre.

Pas një pushimi të shkurtër, seanca filloi në orën 15:00.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim - vendimin për anulimin e Vendimi PA1 nr.08-204, datë 24.07.2024 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë. Ai ka shpjeguar se Këshilli paraprakisht kishte filluar procedurë për heqjen e lejes për shkak se kishte dy kushte të paplotësuara, gjegjësisht nuk kishte paguar kompensim vjetor për lejen dhe nuk kishte numër të të punësuarve në pajtim me Rregulloren për kushtet minimumin teknik, hapësinor, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio. Deri më datën 24.07.2024, kur Këshilli mori Vendimin, transmetuesi ka paguar kompensimin, por kishte të punësuar vetëm 4 persona nga 5 të kërkuar. Prandaj, Këshilli mori vendim të kushtëzuar për t'i mundësuar që gjatë ditës në vijim të dorëzojë dokumentet e nevojshme dhe vendimi të mos botohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së, por fatkeqësisht transmetuesi në këtë afat të shkurtër kohor nuk i ka hequr pengesat ligjore për të mbajtur lejen. Sipas ligjit, leja për TV Kanal Vis i është hequr dhe Vendimi është publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në dy gazeta ditore. Ndërkohë transmetuesi ka vendosur të vazhdojë punën dhe ka paraqitur padi në afatin ligjor prej 30 ditësh në Gjykatën Administrative. Nga shuma e mjeteve që janë paguar në llogarinë e Agjencisë për kompensim, Agjencia ka mbajtur vetëm atë pjesë të kompensimit për periudhën që ai ka punuar, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve i është kthyer në llogarinë e tij. Pas kësaj pasi transmetuesi vendosi që të vazhdojë me punë, në tërësi i ka paguar mjetet financiare për lejen dhe po ashtu në shumë më pak se 52 mijë denarë i ka paguar shpenzimet që ASHMA i kishte bërë për publikimin e Vendimit për heqjen e lejes në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në dy gazeta ditore dhe shpenzimet e ribotimit të Vendimit për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në dy gazeta ditore. Ai ka plotësuar edhe kushtin tjetër, ka dorëzuar dokumentet për numrin e kërkuar të të punësuarve. Mirëpo, për shkak të gabimit teknik të mbiemrit të redaktore përgjegjëse dhe krye redaktore, dokumentet janë kthyer dhe në orën 13:30 të ditës së sotme janë dorëzuar dhe shqyrtuar nga shërbimi profesional, të cilët kanë dhënë mendim se janë në përputhje me Ligjin. Për këtë arsye, sugjerohet që Këshilli të miratojë Vendim për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-204, datë 24.07.2024 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë. Ai ka shpjeguar se transmetuesi me e-mail e ka njoftuar Agjencinë se të hënën do ta tërheqë padinë përmes Gjykatës Administrative për heqjen e lejes. Është mirë që transmetuesi vazhdon të punojë, janë plotësuar kërkesat ligjore, por të punësuarit tek transmetuesi janë regjistruar vetëm për një muaj dhe shpresojnë që në të ardhmen gjendja financiare do të stabilizohet. Ai tha se Agjencia do të vazhdojë të monitorojë gjendjen me transmetuesin në lidhje me numrin e të punësuarve nëse numri i të punësuarve në vazhdimësi do të jetë në përputhje me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

Z. Petrushevski tha se në të gjitha rastet e tilla gjithmonë përkrah mundësinë që çdo media të vazhdojë të punojë, prandaj dhe në këtë rast me kënaqësi do të votojë për anulimin

e Vendimit të Këshillit. Shpreson që në funksionimin e mëtutjeshëm transmetuesi të konsolidohet financiarisht dhe të mundësojë një periudhë më të gjatë për të punësuarit.

Z. Fidanoski tha se nga gjithçka që ndodhi në 50 ditët e fundit lidhur me televizionin KANAL VIS nga Strumica, sipas tij, është evidente se ky transmetues po bën përpjekje të mëtutjeshme që të vazhdojë të ekzistojë në skenën mediatike maqedonase. Kanal Vis është një televizion që ekziston me dekada dhe nga të paktat media rajonale që me të drejtë meriton epitetin se banorët e rajonit juglindor më së shumti zgjedhën dhe ndoqën programin në VIS. Siç tha dhe drejtori Trajçevski, shpreson se transmetuesi do të arrijë të stabilizohet financiarisht për një periudhë më të gjatë. Ai dha mbështetje për vendimin e propozuar dhe tha se do të përsërisë atë që tha drejtori, se Agjencia do ta monitorojë punën e tij nëse ai i plotëson dhe respekton kërkesat ligjore, por në këtë moment beson se është e nevojshme që Këshilli të japë mbështetje dhe t'i mundëson vazhdimin e punës.

Z. Ajdini tha se e kishte shqyrtuar materialin bazuar për këtë pikë dhe është mirë që transmetuesi kishte arritur t'i largonte të metat. Televizioni VIS është një nga televizionet më të vjetra në vend dhe tha se do të japë mbështetje sepse e meriton të punojë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për anulimin e Vendimit PA1 nr. 08-204 , datë 24.07.2024 të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë.07.09.2023.

Detyrohet Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, më së voni deri më 03.09.2024, t'i përmbush detyrimet financiare dhe të tjera, përkatësisht:

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 4.465,00 denarë, me TVSH, për publikimin e Vendimit PA1 nr.08-204 të datës 24.07.2024 për heqjen e lejes, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), nr.159/24 - sipas faturës nr.7125-6849/27 datë 06.08.2024
- të paguajë shpenzimet në shumë prej 41.981,00 denarë, me TVSH për publikimin e Vendimit PA1 nr. 08-204 të datës 24.07.2024 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-816, datë 07.09.2023, në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve në RMV-së (sipas faturës nr.34052/2024 datë 31.07.2024 (nr ynë.ark.05-3535/1 datë 22.08.2024) dhe faturë nr.2410300835 datë 31.07.2024.
- të paguajë shpenzimet në shumë prej 1.083,00 denarë, me TVSH, për publikimin e Aktvendimit për fshirjen nga regjistri i transmetuesve PA1 nr.08-218 datë 08.08.2024, në Gazetën Zyrtare të RMV-së, nr.167/24 – sipas faturës nr.7392-6849/27 datë 15.08.2024 (nr ynë.ark.05-3539/1 datë 22.08.2024);
- t'i paguajë shpenzimet në shumë prej 4.465,00 denarë, me TVSH, për shpalljen e këtij Vendimi për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-204, datë 24.07.2024 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-816, datë 07.09.2023, në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe
- për ta tërhequr Padinë e dorëzuar në Gjykatën Administrative të RMV-së, me datë 29.08.2024 kundër Agjencisë, për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-204, datë 24.07.2024 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023.

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi me datë 04.09.2024, me kusht që Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë t'i përmbushë me kohë të

gjitha detyrimet financiare dhe të tjera ndaj Agjencisë, të parashikuara në pikën 2 të këtij Konkluzioni dhe për këtë t'i paraqesë dëshmi Agjencisë.

Nëse transmetuesi, Shoqëria Tregtare për Rádiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJ P Strumicë, nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të Konkluzionit në afatin e caktuar, mbetet në fuqi Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.08-204 të datës 24.07.2024 për heqjen e lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-816, datë 07.09.2023.

Agjencia në lidhje me Vendimin e miratuar duhet të njoftojë Administratën e RMV-së.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në Gazetën Zyrtare të RMV-së, dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Z. Petrushevski pas votimit në emër të Këshillit, uroi transmetuesin që të vazhdojë luftën për të mbijetuar dhe të vazhdojë të punojë profesionalisht ashtu siç është sipas ligjit.

Pika 7

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**